



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 37.
Prishtinë, më 26.03.2012 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, , Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic dhe Mufera Sinik.

Munguan: Elmi Reçica, Glauk Konjufca Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesi Visar Bivolak – EULEX, përfaqësuesi Ukë Gashi – ZPRK, përfaqësuesja Florije Mehmeti KDI, përfaqësuesi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma ,zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinansijare dhe institucionet jobankare, me raportin e Komisionit funksional për buxhet dhe financa, me amendamente**

***Kryesuesi** - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës , pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinansijare dhe institucionet jobankare, me raportin e Komisionit funksional për buxhet dhe financa, me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinansijare dhe institucionet jobankare, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë të votave, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinansijare dhe institucionet jobankare dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit

Të ndryshme.

Kryesuesi – e informoi Komisionin se lidhur me çështjen e paraqitjes së komunitetit RAE (ashkali, egjiptian, gorn) , në bazë të marrëveshjes së përfaqësuesve të këtyre komuniteteve, mandati në vend të përfaqësuesit Etem Arifi zëvendësohet me përfaqësuesin Xhevdet Neziraj.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic